

ANKETA STRUKTURE E NDËRMARRJEVE

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)
INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse	5
5. Periudha e referencës	5
6. Mandati institucional.....	5
7. Konfidencialiteti	6
8. Politika e botimit.....	7
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	7
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	7
11. Menaxhimi i cilësisë	8
12. Rëndësia.....	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	9
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	10
15. Koherenca dhe Krahueshmëria.....	11
16. Kostoja dhe ngarkesa	12
17. Rishikimi i të dhënave.....	12
18. Përpunimi statistikor	12
19. Komente.....	15
Aneks 1	15

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Drejtoria e Statistikave Ekonomike, Sektori i Statistikave Strukturore
1.3. Personi i kontaktit	Ermira Muhaj (Palushi)
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjës Sektori
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Tiranë, Kodi Postar 1017.
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	epalushi@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	15.02.2023
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	15.02.2023
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	15.02.2023
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Qëllimi kryesor i statistikave strukturore të ndërmarrjeve është të tregojë strukturën e aktiviteteve ekonomike të ndërmarrjeve. Sektori i ndërmarrjeve përfshin të gjitha ndërmarrjet që prodhojnë mallra dhe shërbime për treg. Statistikat strukturore të ndërmarrjeve japin një përshkrim të strukturës ekonomiko-financiare të ekonomisë nëpërmjet vrojtimit të aktiviteteve të njësive të angazhuara në një aktivitet ekonomik. Përcaktimi i prioriteteve bëhet në përputhje me Rregulloren e BE-së 2019/2152 mbi statistikën evropiane të biznesit (rregullorja EBS) dhe rregullën zbatuese 2020/1197 që përcakton specifikimet dhe marrëveshjet teknike (akti i përgjithshëm zbatues). Këto statistika i shërbejnë më së miri të gjithë komunitetit të biznesit, politikëbërësve si edhe akademikëve për të kryer analiza të detajuara të strukturës ekonomike në vend.</p>
3.2. Sistemi i klasifikimit	Klasifikimi i përdorur për statistikën strukturore të ndërmarrjeve është Klasifikimi Statistikor i Aktiviteteve Ekonomike (NVE). Të dhënat janë

	<p>prodhuar në nivel vendi, të detajuara sipas aktivitetit ekonomik të grupuar në nivel dy shifror të kësaj nomenklature. Deri në vitin 2012, të dhënat janë mbledhur dhe publikuar duke përdorur NVE Rev.1.1. Për vitin referencë 2010-2012, është kryer kodifikimi i dyfishtë, në NVE Rev.1.1 dhe NVE Rev.2. Duke filluar nga viti referencë 2013, të dhënat janë mbledhur dhe publikuar në NVE Rev.2. Një gamë e gjerë e klasifikimeve statistikore përdoret në statistikat e ndërmarrjeve. Lista e klasifikimeve të përdorura në prodhimin e statistikave strukturore të ndërmarrjeve është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev 2</u> NVE Rev. 2 • <u>Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike Rev 1.1</u> NVE Rev. 1.1 • Rekomandimi i BE-së Nr. 2003/361 në lidhje me përkufizimet e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme. • Ligji Nr. 43/2022, “Për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” • Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat, NUTS1 dhe NUTS 2 <p>Ndërmarrjet janë të klasifikuara sipas madhësisë bazuar në numrin mesatar të të punësuarve gjithsej.</p>
<p>3.3. Mbulimi i sektorit</p>	<p>Statistikat strukturore të ndërmarrjeve përfshijnë të gjitha ndërmarrjet aktive në Shqipëri, për të gjitha format ligjore. Popullsia është bazuar në ndërmarrjet të cilat, sipas Regjistrimit Statistikor të Ndërmarrjeve, ishin aktive në Dhjetor të vitit të referencës dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në një prej aktiviteteve të mbuluara nga ASN. Statistikat strukturore të ndërmarrjeve mbulojnë ndërmarrjet që operojnë në treg, të cilat bazuar në klasifikimin NVE Rev. 2, kanë aktivitet kryesor në: (B) Industri nxjerrëse, (C) Industri Përpunuese, (D) Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar, (E) Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit, (F) Ndërtimi, (G) Tregtia me shumicë dhe pakicë. Riparimi i automobilave e motorçikletave, (I) Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit, (H) Transport dhe Magazinim, (J) Informacioni dhe Komunikacioni, (L) Pasuritë e patundëshme, (M) Aktivitetet Profesionale, Shkencore dhe teknike (N) Aktivitetet Administrative dhe Shërbimet mbështetëse, (P) Arsimi, (Q) Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale, (R) Art, Argëtim dhe zbavitje, (S) Aktivitete të tjera shërbimi (përfshijë S94).</p>
<p>3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p>Treguesit bazë Ndërmarrja është: "kombinimi më i vogël i njësive ligjore pra një njësi organizative që prodhon të mira apo shërbime që ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose me shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale)". Marrëdhënia mes një ndërmarrje dhe një njësie ligjore përkufizohet si: "ndërmarrja i korrespondon ose një njësie ligjore ose një kombinimi njësisish ligjore".</p> <p>Të punësuarit përfshijnë të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjestarët e familjes të papaguar.</p> <p>Shitjet neto përfshijnë shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë periudhës referuese dhe i korrespondojnë shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve ofruar të tretëve.</p>

	<p>Investimet gjatë periudhës referuese përfaqësojnë vlerën e mallrave afatgjata të blera prej ndërmarrjeve ose të krijuara për llogari të vet me qëllim përdorimi për një periudhë jo më të vogël se një vit në procesin e prodhimit, përfshirë tokën.</p> <p>Tregues makroekonomikë</p> <p>Prodhimi është një aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale (ndërmarrje) që kombinon burimet e fuqisë punëtore, kapitalit dhe lëndës së parë, për të prodhuar të mira dhe kryer shërbime. Vlera e prodhimit bazohet në: Të ardhurat nga shitja e produkteve dhe shërbimeve (shitjet neto) të krijuara nga vetë ndërmarrja: (±) Ndryshimet e gjendjen së produkteve të gatshme dhe në proces. (±) Ndryshimet në gjendjen e mallrave dhe shërbimeve të blera për rishitje në të njëjtat kushte (-) Blerjet e mallrave dhe shërbimeve për rishitje në të njëjtat kushte (+) Prodhimi i aktiveve të qëndrueshme nga ndërmarrja për llogari të vet (+) Subvencionet.</p> <p>Konsumi ndërmjetës përfaqëson vlerën e produkteve ose shërbimeve të transformuara ose plotësisht të konsumuara gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk përfshihet në vlerën e konsumit ndërmjetës.</p> <p>Vlera e shtuar me çmime bazë llogaritet si diferencë e vlerës së prodhimit me konsumin ndërmjetës.</p>
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore e synuar dhe e vrojtuar është ndërmarrja. Të dhënat e publikuara sipas aktiviteteve ekonomike dhe madhësisë së ndërmarrjes i referohen ndërmarrjes.
3.6. Popullata statistikore	<p>Statistikat përfshijnë të gjitha ndërmarrjet aktive në Shqipëri, të gjitha formave ligjore. Baza e zgjedhjes janë të gjitha ndërmarrjet ku sipas Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve (RSN), janë aktive në Dhjetorin e vitit referencë për aktivitet që mbulon ASN duke përjashtuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njësitë lokale • Ndërmarrjet që kanë kodin e aktivitetit ekonomik kryesor (NVE) jashtë qëllimit të këtij vrojtimi. • Ndërmarrjet shtetërore në aktivitetet e arsimit (NVE 85) dhe shëndetësisë (NVE 86, 87, 88).
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e ASN mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Ky aktivitet statistikor ka filluar në vitin 1998, por vitet e para (deri në 2001) kanë shërbyer si periudhë tranzicioni. Të dhënat janë më të plota dhe të krahasueshme duke filluar nga viti referencë 2002. Deri në vitin referencë 2011, të dhënat janë publikuar në NVE Rev.1.1. Të dhënat e ASN janë rillogaritur me klasifikimin NVE Rev 2 nga viti referencë 2010 dhe në vazhdim.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.

<p>4. Njësia matëse</p>	<p>Është përdorur numri si njësi matëse për listën e mëposhtme të treguesve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Numri i ndërmarrjeve. • Numri mesatar vjetor i të punësuarve. • Numri mesatar vjetor i të punësuarve me pagesë. • Numri i të punësuarve në fund të vitit. • Numri i femrave në fund të vitit. • Numri i të vetë-punësuarve në fund të vitit. • Numri i të punësuarve me pagesë në fund të vitit. Përqindja është përdorur për listën e mëposhtme të treguesve makroekonomikë: <p>Njësia Milionë Lekë është përdorur për të dhënat financiare, të investimeve dhe tregues makroekonomikë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlera e Prodhimit • Konsumi Ndërmjetës • Vlera e Shtuar
<p>5. Periudha e referencës</p>	<p>Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Ky raport i përket vitit referencë 2021.</p>
<p>6. Mandati institucional</p>	
<p>6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera</p>	<p>Baza ligjore mbi të cilën u mbështetet vërtetimi vjetor statistikor i ndërmarrjeve përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”</u> • <u>Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026,</u> • Vendimet e Këshillit të Statistikave. Duke qenë se, sipas ligjit të 6 statistikave zyrtare, roli i këtij organi është të mbikëqyrë, mbështesë dhe të marrë vendime në ndihmë të INSTAT-it dhe agjencive të tjera statistikore për të siguruar hartimin dhe zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, aktet e miratuara nga ky organ janë të rëndësishme për ecurinë e zbatimit të aktiviteteve statistikor si dhe monitorimin e performancës së institucioneve përbërëse të sistemit kombëtar statistikor. • Memorandumet e bashkëpunimit të hartuara me institucionet e tjera edhe pse Shqipëria nuk është ende pjesë e Bashkimit Europian. INSTAT kryen të gjitha aktivitetet statistikore në përputhje me rregulloret respektive të EUROSTAT. Rezultatet e statistikave strukturore të ndërmarrjeve në mënyrë që të jenë të krahasueshme me ato të vendeve evropiane, prodhohen duke zbatuar edhe rregulloret e reja të Komisionit Evropian, KE: <ul style="list-style-type: none"> ○ <input type="checkbox"/> Rregulloren e Komisionit Evropian Nr.1893/2006 mbi “Implementimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike. NVE Rev.2 në Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve; ○ <input type="checkbox"/> Rregulloren e BE-së 2019/2152 mbi statistikave evropiane të biznesit (rregullorja EBS); ○ <input type="checkbox"/> Rregullin zbatues 2020/1197 që përcakton specifikimet dhe marrëveshjet teknike (akti i përgjithshëm zbatues).

6.2. Shkëmbimi i të dhënave	<p>Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve kanë filluar të transmetohen në EUROSTAT që prej vitit reference 2017. Të dhënat e vitit 2019-2020 janë validuar dhe publikuar në faqen e Eurostat. Aktualisht INSTAT plotëson një sërë pyetësorësh të organizmave ndërkombëtarë në lidhje me rezultatet e vrojimit strukturor vjetor, si Komisioni Europian, Enterprise and Industry Directorate-General, OECD, etj.</p>
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018, "Për Statistikat zyrtare";, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrotjtja e të Dhënave Personale". Neni 31, i ligjit "Për Statistikat zyrtare" përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrotuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.</p> <p>Nga të dhënat në nivel individual të ASN largohen të gjitha të dhënat demografike të ndërmarrjes, si Nipt-i, emri i ndërmarrjes, emri dhe mbiemri i presidentit, data e krijimit të ndërmarrjes dhe adresa e saj. Fillimisht shënjohej me (c) si konfidenciale rastet e grupimeve që kanë 3 ose më pak ndërmarrje si</p>

	edhe rastet kur përqindja që zënë dy ndërmarrjet më të mëdha kalon 85%. Më pas shënjohe me (c) rastet të cilat do të çonin në identifikimin indirekt të ndërmarrjeve.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftimet dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesit në kalendarin e publikimeve	<u>Kalendari i Publikimeve</u> është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesit i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit tremujor të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve janë si më poshtë: 1. Website – online release 2. Kërkesat e shkruara (me postë ose <u>email</u>); 3. Publikimi Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve 4. Seksioni <u>kërkesa të dhënash</u> , për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshhtësia e shpërndarjes	Rezultatet e ASN publikohen në baza vjetore.
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me katër treguesit kryesorë, numri i ndërmarrjeve, numri i të punësuarve, shitjet neto dhe investimet. Formatit i njoftimit për shtyp nuk ka ndryshuar; ajo është përcaktuar nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp publikohet online në faqen e internetit të INSTAT: <u>Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve Ekonomike</u> .
10.2. Publikime	Rezultatet e ASN gjenden të botuara në Vjetarin Statistikor. Përdoruesit mund ti gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT: <ul style="list-style-type: none"> • <u>Shifrat</u> • <u>Vjetari Statistikor</u>
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e ASN nga viti 2002 si viti referencë. Bazën e të dhënave mund t'a aksesoni në linkun si vijon: <u>Databaza Statistikore</u> .

10.4. Aksesi në të dhënat mikro	Të dhënat e ASN nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 17/2018.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për <u>Kërkesë të Dhënash</u> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me <u>Metodologjinë mbi vrojtimin</u> .
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave Strukturore dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e ASN për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Nr.17/2018 “Për Statistikat zyrtare”, datë 05.04.2018”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e ASN krahasohen me të dhënat e ASN në vitet e para për të dalluar nëse ka koherence të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha. Në rastet e ndryshimeve përdoren të dhënat administrative për të konfirmuar situatën e rasteve kur hasen diferenca të mëdha të sjelljes së një viti me vitet e tjera.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e ASN-së ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm. <ul style="list-style-type: none"> • Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë: <ul style="list-style-type: none"> ○ Institucione të administratës publike ○ Universitetet ○ Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare ○ Bizneset ○ Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. Botimi i rezultateve të ASN-së dërgohet çdo vit në një grup të caktuar

	<p>përdoruesish. Disa tregues kryesorë dërgohen nga plotësimi i pyetësorëve të ndryshëm në Komisionin Europian, Enterprise and Industry Directorate-General, OECD, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Me përdorues të brendshëm nënkuptojmë: <ul style="list-style-type: none"> ○ Drejtoria e Llogarive Kombëtare ○ Sektori i Statistikave Afat-Shkurtra ○ Sektori i Regjistrimit statistikor të Ndërmarrjeve ○ Sektori i Statistikave të Tregut të punës
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Page Views (Klikime) në lidhje me Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve Ekonomike për vitin 2022 janë rreth 5.379 klikime.</p> <p>Gjatë 2022 INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve. Rezultatet e vrojtimit për 2022 tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës "Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve Ekonomike" është vlerësuar me 3.66 (73.11 %) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit <u>Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</u>.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave të ASN-së gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të rregulloreve të ndjekura. Rezultatet e statistikave strukturore të ndërmarrjeve në mënyrë që të jenë të krahasueshme me ato të vendeve evropiane, prodhohen duke zbatuar edhe rregulloret e reja të Komisionit Evropian, KE:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloren e KE Nr. 1893/2006 mbi “Implementimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 në Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve; • Rregulloren e KE Nr.295/2008 mbi “Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve”; • Rregulloren e KE Nr.250/2009 mbi “Përkufizimet e përdorura në Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve” <p>Shkalla e Plotshmërisë të të dhënave, për Anketën Strukturore të Ndërmarrjeve (ASN) 2021, është 80 %.</p>
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishme në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime të dhënave të anketës kontrollohen me pasqyrat financiare ose me burime administrative nëse ka informacion. Kur nuk ka informacion nga burimet administrative INSTAT korrigjon ose konfirmon të dhënat duke përdorur email ose duke telefonuar personat që i janë përgjigjur anketës. Masat e marra nga INSTAT çdo vit, për të rritur normat e përgjigjes, ose për të zvogëluar ndikimin e mos përgjigjeve janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dhënat merren drejtpërdrejt nga ndërmarrja • Informacioni është mbledhur me intervistim ballë për ballë nga anketuesit në bazë të udhëzimeve të përgatitura për këtë qëllim. • Stafit anketues është i trajnuar se si të sillen në mënyrë etike me rastet e personave të cilët refuzojnë të përgjigjen.

	<ul style="list-style-type: none"> • Për shkak të mungesës së sistemit të adresave, shpesh nga anketuesit është e vështirë gjetja e ndërmarrjes. Për këtë arsye, stafi i INSTAT nëpërmjet adresës së email-it ose numrit të telefonit kontakton personin përgjegjës për plotësimin e anketës dhe merr më tepër informacion mbi vendodhjen si edhe datën dhe orën e takimit. • Prioritet i jepet bizneseve të mëdha. Kur këto ndërmarrje refuzon të përgjigjet për intervistuesit, një kërkesë zyrtare i drejtohet presidentit të ndërmarrjes, e cila është e nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm i INSTAT; • Kërkesë zyrtare dërgohet edhe për ndërmarrje të tjera që pranojnë të përgjigjen vetëm nëse ju kërkohet zyrtarisht informacioni. • Ndërmarrjet janë të ftuar të kontaktojnë zyrat qendrore të Institutit të Statistikave në rast të pyetjeve dhe gjithmonë një staf i kualifikuar është në dispozicion për t'iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga ndërmarrjet. • Ndërmarrjeve më të mëdha ju dërgohen çdo vit botime të INSTAT. 						
13.2. Gabim i kampionimit	Treguesit e gabimeve të kampionimit janë llogaritur për indikatorët kryesorë: Shitje neto, Të punësuar dhe Numër ndërmarrjesh gjithsej në nivel seksioni dhe total vendi, të cilët i gjeni të pasqyruara në Aneks1. Të gjitha vlerat e treguesve përgjithësohen për të përfaqësuar gjithë popullatën në studim.						
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Mos-përgjigja në nivel rekordi merr në konsideratë ndërmarrjet që nuk janë në gjendje apo të gatshme për të dhënë përgjigje, kur intervistuesit nuk janë në gjendje për të gjetur ndërmarrjet, kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën, apo kur është e pa mundur për të gjetur informacion nga burime të tjera administrative rreth ndërmarrjes. Shkalla e mospërgjigjes në nivel rekordi për ASN 2021 është 12.0 %.</p> <p>Shkalla e Mos-përgjigjes në nivel variabli për variablat kryesor të ASN 2021 është: për Shitjet neto është 2.0 % dhe për Numrin e të punësuarve gjithsej është 3.3 %.</p> <p>Mbi-mbulimi ndodh kur ndërmarrja e zgjedhur është në një aktivitet të caktuar objekt i anketimit dhe gjatë procesit të intervistimit ajo nuk është më objekt i anketimit. Shkalla e mbi-mbulimit për ASN 2021 është 3.1%.</p>						
14. Afatet kohore dhe përpikmëria							
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e “Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve” janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT rreth 411 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 411 ditë). Periudha referuese e rezultateve të ASN 2021 është 31 Dhjetor 2021.</p> <table border="1" data-bbox="483 1727 968 1854"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>2/15/2023</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>411</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021	Data e publikimit	2/15/2023	Afatet kohore	411
Periudha referuese	12/31/2021						
Data e publikimit	2/15/2023						
Afatet kohore	411						
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat e Anketës së ASN, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i ASN 2021 ka qenë i përpiktë në kohë në 100 %.</p> <table border="1" data-bbox="483 1995 968 2031"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2021</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2021				
Periudha referuese	12/31/2021						

	Data e shpallur	2/15/2023
	Data e publikimit	2/15/2023
	Vonesa në kohë	0
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria		
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>INSTAT përdor aspektet metodologjike të cilat janë të bazuara në konceptet, përkufizimet dhe udhëzimet e Rregullores së BE-së 2019/2152 mbi statistikat evropiane të biznesit (rregullorja EBS) dhe rregulloren zbatuese 2020/1197 që përcakton specifikimet dhe marrëveshjet teknike (akti i përgjithshëm zbatues). Kështu të dhënat e Shqipërisë mund të jenë të krahasueshme me vendet e BE apo vendet candidate.</p> <p>Në lidhje me periudhën referuese, Shqipëria përdor vitin kalendarik, që korrespondon me vitin fiskal.</p> <p>Popullsia përbëhet nga të gjitha ndërmarrjet që, sipas regjistrimit statistikor të ndërmarrjeve, ishin aktive në Dhjetor të vitit referues.</p> <p>Klasifikimi i ndërmarrjeve bëhet në bazë të Klasifikimit të Veprimtarive Ekonomike, Nve Rev.2 sipas Rregullores (KE) Nr 1893/2006 për "Zbatimin e Nve Rev. 2 në statistikat strukturore të ndërmarrjeve";</p> <p>Deri më tani njësi statistike në ASN ka qenë ndërmarrje, pasi ajo përkon me njësinë ligjore në Shqipëri.</p>	
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Për shkak të zbatimit të NVE Rev.2, të dhënat SBS kanë një ndërprerje të serive kohore. Statistikat ASN-së janë dhënë çdo vit dhe janë të krahasueshme nga viti 1998 deri në 2013. Seria kohore ekziston që nga viti 1998 (si vit reference), por të dhënat nga viti 2002 e në vazhdim janë më të besueshme.</p> <p>Bazuar në NVE Rev 1.1 klasifikimi i të dhënave ASN janë të krahasueshme me kalimin e viteve 2002 deri në 2012, duke mundësuar një krahasueshmëri në seri kohore prej 11 vitesh vitesh ($CC2=Jlast-Jfirst+1=11$).</p> <p>Në NVE Rev 2 të dhënat e ASN janë siguruar nga viti 2010 e në vazhdim, duke mundësuar një krahasueshmëri në seri kohore prej 12 vitesh ($CC2=Jlast-Jfirst+1=12$).</p> <p>Duke filluar nga viti 2010 janë shtuar dy aktivitete të reja (arsimi dhe shëndetësia private) dhe përjashtohet peshkimi. Për aktivitete të tjera, të dhënat ASN janë të krahasueshme në vite.</p>	
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	<p>Të dhënat e publikuara në statistikat strukturore të ndërmarrjeve mund të gjenden në këto fusha të ndërlidhura: statistikat afatshkurtra, statistikat e tregut të punës dhe Anketa e Forcave të Punës (AFP). Pavarësisht ngjashmërisë të treguesve të prodhuar nga këto fusha, duhet theksuar se dallime metodologjike ekzistojnë mes të dhënave të ASN dhe të dhënave nga statistikat e tregut të punës, Anketës së Forcave të Punës dhe statistikave afatshkurtra. Për shembull, statistikat e punësimit me të dhënat e ASN ndryshojnë sepse në AFP janë pyetur persona në qoftë se ata kanë qenë të zënë në punë për vitin referues ndërsa në ASN pyetet ndërmarrja për numrin e personave të punësuar. Treguesi i shitjeve neto krahasohet me shitjet neto në Statistikat Afatshkurtra vetëm për të parë ecurinë e treguesit sepse fusha e mbulimit për këto vrojtme ndryshon.</p>	

15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre.
16. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Personat që punojnë për ASN janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stafi i përgjithshëm në Zyrat Qendrore: 5 punonjës • Stafi në Zyrat Rajonale, 11 punonjës • Intervistuesit, Operator, Kontrollor (Staf i përkohshëm i INSTAT): 220 Intervistues +10 Kontrollorë + 11 Operatorë.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit të ASN bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <u>Politika e Revizionimit Statistikor</u> • <u>Politika e Trajtimit të Gabimeve</u> <p>Të dhënat paraprake deri në publikimin e rezultateve përfundimtare janë në proces rishikimi. Rishikimi nënkupton plotësimin e vazhdueshëm të të dhënave. Saktësia e të dhënave të publikuara mund të rritet si pasojë e ndryshimeve që mundësohen nga sigurimi i të dhënave të reja më të plota dhe më cilësore, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e rezultateve paraprake, të publikuara sipas afateve të parapërcaktuara në kalendarin e publikimeve.</p>
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Të dhënat e ASN rishikohen në rastet kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zbatohet një klasifikim i ri aktivitetesh • Ka ndryshime metodologjike • Rishikohen peshat (burime të reja dhe / ose burimeve të përmirësuara, korrigjime të gabimeve) <p>ASN përpiqet të ndjekin udhëzimet standarde dhe parime në rishikimet e bëra në bashkëpunim me asistencën teknike të marrë nga eksperiencat më të mira të vendeve të bashkimit evropian. Të gjitha rishikimet janë bërë transparente për përdoruesit dhe janë pjesë e çdo botimi.</p>
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	<p>Si burim i vetëm i mbledhjes së të dhënave është vrojtimi. Si bazë e zgjedhjes shërben regjistri i përditësuar i ndërmarrjeve, të cilat ishin aktive në Dhjetor të vitit të referencës. Nga ky regjistër përjashtohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njësia lokale • Ndërmarrjet me veprimtari jashtë fushë së mbulimit të ASN • Ndërmarrjet shtetërore në Arsim (NVE Rev. 2 85) dhe Shëndetësi (NVE Rev. 2 86, 87, 88). <p>Në këtë mënyrë krijohet Frame i cili në total ka 113,137 ndërmarrje nga të cilat u përzgjedh kampioni me madhësi prej 19,622 ndërmarrje. Metoda e përzgjedhjes së përdorur është “Stratified Systematic Random</p>

	<p>Sampling (SRS)”. Shtresëzimi bazohet kryesisht në NACE Rev.2, 2 shifror dhe madhësia e ndërmarrjeve (numri i të punësuarve). Për zgjedhjen e kampionit të ASN 2021, është bërë revizionimi i sample të ASN duke e shtrirë mbulimin e aktivitetit në nivel 3 shifror për aktivitetet me peshën më të madhe në ekonomi;</p> <p>Klasifikimi i ndërmarrjeve sipas aktivitetit bëhet sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike, NACE Rev.2. Klasifikimi i ndërmarrjeve sipas madhësisë bëhet sipas numrit të të punësuarve (të matur si të punësuar me orar të plotë).</p> <p>Për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë kampion me zgjedhje për anketim. Ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht. Metoda e përdorur për shpërndarjen e kampionit nëpër shtresa (strata) është metoda e “Neyman Allocation”, në domeinet e publikimit.</p>
<p>18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave</p>	<p>Të dhënat grumbullohen në baza vjetore.</p>
<p>18.3. Grumbullimi i të dhënave</p>	<p>Të dhënat e ASN mblidhen me intervistim ballë për ballë me pyetësorë letër. Programet dhe procedurat e nevojshme për hedhjen manuale të të dhënave përgatiten para se të fillojë mbledhja e të dhënave. Paraprakisht procedurat dhe programet e nevojshëm janë testuar dhe janë bërë korrigjimet eventuale. Të gjitha të dhënat janë të integruara në një bazë të dhënash të vetme, pasi është kryer hedhja dhe kontrolli i të dhënave. Vrojtimi i ASN-së ka katër pyetësorë për katër aktivitetet kryesore (të industrisë, ndërtimit, tregtisë dhe shërbimeve). Para kryerjes së anketës përdoruesit kryesorë pyeten mbi nevojat që ata kanë për shtim të pyetjeve në pyetësor. Bazuar në rezultatet e këtyre nevojave bëhet dhe dizënjimi final i pyetësorit i cili nuk ka ndryshime të mëdha në vite.</p> <p>Faza e rëndësishme në përgatitjen për grumbullimin e të dhënave është përgatitja e të gjitha materialeve të nevojshme dhe e programeve të hedhjes dhe të përpunimit të të dhënave. Duhet që të jenë përcaktuar ndërmarrjet që do intervistohen, numri i nevojshëm i anketuesve dhe duhet të jetë bërë përzgjedhja e tyre. Gjatë trajnimit të organizuar për anketuesit se si të kryejnë vrojtimin ata gjithashtu pajisen materiale të nevojshme si udhëzuesi i pyetësorit, detyrat e anketuesit, lista e aktiviteteve ekonomik, lista e produkteve, letër njoftimit për ndërmarrjet etj. Në procesin e mbledhjes së të dhënave janë të regjistruar çdo gjë e raportuar nga ndërmarrjet. Në rast të paqartësive, ndërmarrja ri-kontaktohet. Në rast të mospërgjgjes, ndërmarrjes i dërgohet një shkresë zyrtare e nënshkruar nga titullari i Institucionit. Anketuesit i kërkohet të sillet në mënyrë etike në rastet e refuzimeve nga ndërmarrjet.</p>
<p>18.4. Vlefshmëria e të dhënave</p>	<p>Sa i përket vlefshmërisë së të dhënave, procedurat e redaktimit të të dhënave në përgjithësi i referohen redaktimit në nivel mikro ose ndryshe në nivel ndërmarrje.</p> <p>1. Kontrolli fizik i pyetësorit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli i pyetësorëve të mbledhur, kontrole të tërësisë së plotësisimit, saktësisë së vlerave dhe kontrollit logjik i pyetësorit. Staf i kontrollues ka një program specifik për të kryer kontrollin matematikore të pyetësorit.

	<p>Numri i pyetësorëve të mbledhur duhet të jetë i barabartë me numrin e pyetësorëve të shpërndarë në qarqe.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolle individuale janë bërë për rastet e refuzimit dhe pa kontakte. • Ndërmarrjet e përgjigjura kontrollohen për koherencën e të dhënave midis sesioneve të ndryshme të pyetësorit. • Kontrolli i indikatorit të ndërmarrjes dhe aktivitetit ekonomik dhe kodimi i tyre. <p>2. Kontrolli i informacionit të vrojtimit me burimet administrative.</p> <p>3. Peshat e përshtatshme ri-llogaritet për çdo njësi që ka raportuar të dhënat e saj.</p> <p>Kjo peshë është ri-llogaritur për arsye të ndryshme: probabilitetit të pabarabartë të përzgjedhjes, jo-përgjigje, rregullimit të vlerave të popullsisë, vlerësimi i modelit etj. Trajtimi i outlier-ave merret parasysh në procedurat e përgjithësimit të rezultateve.</p>
<p>18.5. Përpilimi i të dhënave</p>	<p>Për përpilimin e rezultateve kemi tre procedura bazë:</p> <p>1. Analiza e cilësisë së të dhënave</p> <p>Për të analizuar cilësinë e të dhënave janë aplikuar disa rregulla:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli matematik i anketës - Kontrolli logjik i të dhënave të anketës • Krahasimi i të dhënave në seri kohore -Krahasimi i të dhënave me skedarë të tjerë që disponon INSTAT • Krahasimi i të dhënave me skedarin e bilanceve. • Krahasimi i të dhënave me skedarin e Listë pagesës. • Përcaktimi i kufizimeve për disa raporte, si psh: paga mesatare për të punësuar, marzhet ndaj shitjes neto, etj. • Analiza e shmangieve të mëdha nga mesatarja. <p>2. Trajtimi i mos-përgjigjeve</p> <p>Konsiderohen si mos-përgjigje të gjitha rastet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pa kontakt • Refuzim i plotë • Refuzime të pjesshme, (për tabela apo tregues të veçantë). <p>A. Për trajtimin e mos-përgjigjeve të pjesshme u përdorën disa metoda të drejtpërdrejta ose kombinimi i tyre si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studimi i serisë kohore të ndërmarrjes dhe degës; • Të dhënat nga skedari i bilanceve; • Të dhënat nga skedari i Liste pagesës; • Skedarët e tjerë që disponohen në INSTAT; • Analizohen dhe përdoren të dhënat mesatare të degës ku bën pjesë ndërmarrja; • Përdoren të dhënat e ndërmarrjeve që kanë kushte të ngjashme; • Përdoret metoda e strukturës mesatare sidomos për shpenzimet; <p>3. Procedura e ri-peshimit</p> <p>Për pjesën e pa trajtuar përdoret metoda e ri-peshimit.</p> <p>Programet në SAS Software, Macro Clan përdoren për ripeshim dhe për vlerësimin e të dhënave. Vlerësimi bëhet sipas metodës tradicionale të Horvitz-</p>

	Thompson (i njohur edhe si vlerësuesi π), i cili aplikohet që nga faza e dizenjimit të SRS.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet. Asnjë përshtatje sezonale nuk i bëhet të dhënave të grumbulluara nga ASN.
19. Komente	

Aneks 1

Më poshtë jepen vlerësimet në nivel seksioni dhe total vendi për treguesit kryesorë: Shitje neto, Të punësuar dhe Numër ndërmarrjesh gjithsej së bashku me Koeficientet e Variacionit përkatës.

Tabela 1

Seksioni	Shitjet Neto	Devijimi Standard	Intervali i Besimit 95%		Koeficienti i Variacionit (%)
			Limiti i poshtem	Limiti i Sipërm	
B	73,195,786	936,153	71,360,925	75,030,646	1.3
C	321,102,612	1,295,327	318,563,770	323,641,454	0.4
D	192,725,676	3,570,228	185,728,029	199,723,323	1.9
E	29,586,020	852,955	27,914,228	31,257,813	2.9
F	312,723,989	4,959,215	303,003,927	322,444,051	1.6
G	1,226,875,872	7,244,391	1,212,676,866	1,241,074,879	0.6
H	82,774,698	1,362,866	80,103,481	85,445,915	1.6
I	68,281,681	1,097,649	66,130,289	70,433,073	1.6
J	104,680,404	1,289,492	102,153,000	107,207,809	1.2
L	11,985,247	487,833	11,029,095	12,941,400	4.1
M	71,713,501	1,730,215	68,322,280	75,104,723	2.4
N	77,226,294	1,894,813	73,512,461	80,940,128	2.5
P	14,026,682	200,133	13,634,421	14,418,944	1.4
Q	40,868,754	903,787	39,097,330	42,640,177	2.2
R	11,584,229	436,800	10,728,100	12,440,358	3.8
S	12,888,803	309,905	12,281,390	13,496,216	2.4
Total	2,652,240,250	10,162,383	2,632,321,979	2,672,158,521	0.4

Tabela 2

Seksioni	Të Punësuarit	Devijimi Standard	Intervali i Besimit 95%		Koeficienti i Variacionit (%)
			Limiti i poshtem	Limiti i Sipërm	
B	9,355	120	9,119	9,591	1.3
C	101,721	541	100,661	102,780	0.5
D	10,794	69	10,658	10,930	0.6
E	12,028	53	11,925	12,131	0.4
F	53,874	966	51,981	55,768	1.8
G	130,625	1,018	128,629	132,620	0.8
H	20,776	262	20,263	21,290	1.3
I	50,354	783	48,820	51,889	1.6
J	21,526	296	20,946	22,106	1.4
L	2,971	168	2,642	3,300	5.6
M	23,108	400	22,323	23,892	1.7
N	41,713	321	41,084	42,342	0.8
P	10,226	126	9,979	10,474	1.2
Q	12,425	218	11,997	12,853	1.8
R	5,454	128	5,202	5,705	2.4
S	12,249	233	11,792	12,707	1.9
Total	519,199	1,633	515,997	522,400	0.3

Tabela 3

Seksioni	Nd.gjithsej	Devijimi Standard	Intervali i Besimit 95%		Koefficienti i Variacionit (%)
			Limiti i poshtëm	Limiti i Sipërm	
B	691	41	610	772	6.0
C	7,724	174	7,382	8,066	2.3
D	428	23	382	474	5.5
E	291	29	235	347	9.8
F	5,035	148	4,745	5,324	2.9
G	39,791	378	39,049	40,533	1.0
H	5,342	134	5,080	5,605	2.5
I	16,216	261	15,704	16,727	1.6
J	3,349	143	3,070	3,629	4.3
L	1,040	63	916	1,164	6.1
M	7,528	186	7,163	7,893	2.5
N	3,225	107	3,015	3,434	3.3
P	1,137	43	1,053	1,222	3.8
Q	3,438	91	3,260	3,616	2.6
R	1,120	46	1,030	1,211	4.1
S	7,675	103	7,473	7,876	1.3
Total	104,031	407	103,234	104,828	0.4